

VENDIM

Nr., datë2019

PËR PROCEDURËN E SHKËMBIMIT TË BANESËS ME KOSTO TË ULËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 48 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Familjet që kanë siguruar banesa sociale me kosto të ulët, të cilat më vonë rezultojnë nën normat e strehimit për shkak të ndryshimit të përbërjes familjare dhe aplikojnë në njësinë e vetëqeverisjes vendore për zgjerim nëpërmjet programit të banesave me kosto të ulët, dorëzojnë banesën që kanë përfituar më parë, në shkëmbim të një banese sipas normave të strehimit që i përshtaten familjes.
2. Vlerësimi i banesave që shkëmbehen, kur njësia e vetëqeverisjes vendore ka siguruar banesën me kosto të ulët përmes ndërtimeve të reja, kryhet si më poshtë:
 - a. Vlera e banesës që dorëzohet nga individ/familja, vlerësohet nga subjekti që zbaton programin me koston e ndërtimit, duke zbritur vlerën e amortizimit.
 - b. Vlera e banesës që shkëmbehet me banesën e dorëzuar nga familja përfshin të gjitha kostot që janë investuar për sigurimin e banesës, ku përfshihen:
 - i. kostot e ndërtimit:
 - kostot e projektit;
 - kostot e ndërtimit të objektit, mbikqyrjes, kolaudimit;
 - kostot për lidhjen e objektit me energji, ujë, kanalizime e telefoni;
 - kostot për regjistrimin në ASHK;
 - ii. kostot operacionale, ku përfshihen kostot për punën e stafit të angazhuar, materiale, energji, etj., të cilat miratohen me vendim të organit drejtues të institucionit që zbaton programin, të shprehur në përqindje ndaj koston së ndërtimit sipas germës (b), pika (i), por jo më shumë se 1% kur projekti është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
 - iii. shpenzime për marrjen e lejeve, regjistrimin në ASHK, taksa e detyrime të tjera që nuk janë përfshirë në pikat (i) e (ii);

- iv. vlera e truallit, e cila përcaktohet sipas vlerave të tregut të miratuara me vendim të këshillit të ministrave për qëllim kompensimi.
3. Diferenca që rezulton midis vlerës së banesës që shkëmbehet me vlerën e banesës që dorëzohet nga qytetari, shlyhet në mënyrë të menjëhershme ose me këste. Afati i shlyerjes dhe interesi vjetor përcaktohen nga subjekti që zbaton programin dhe miratohen me vendim të organit drejtues.
4. Në rastet kur banesa me kosto të ulët është siguruar nëpërmjet blerjes në tregun e lirë, vlerësimi i banesave që shkëmbehen bëhet si më poshtë:
 - a. Vlera e banesës që dorëzohet nga qytetari vlerësohet nga vlerësues të licencuar;
 - b. Vlera e banesës në pronësi të subjektit që zbaton programin, e cila do të shkëmbehet, përfshin sa më poshtë:
 - i. Vlerën me të cilën është blerë banesa në treg;
 - ii. Kostot për regjistrimin në ASHK, për lidhjen e kontratës dhe çdo shpenzim tjetër i faturuar;
 - iii. Shpenzimet operationale, të cilat, kur programi zbatohet nga njësi e vetëqeverisjes vendore, nuk mund të jenë më shumë se 0,5% e çmimit të blerjes sipas pikës (i) të germës (b) të kësaj pike.
5. Procedura e shkëmbimit të banesave sociale për individët/familjet e interesuar që janë në kushtet e pikës 1 të këtij vendimi fillon kur subjekti që zbaton programin ka siguruar banesa me kosto të ulët nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu i lire për t'ua shitur individëve/familjeve që kanë aplikuar për këtë program sipas VKM nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore".
6. Struktura e strehimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, verifikon gjendjen e familjes, të sipërfaqes së banimit në banesën ekzistuese të përfituar nga privatizimet ose nga blerja në treg, si dhe të mundësive për ofrimin e një banese me kosto të ulët në përputhje me normat e strehimit të zbatueshme për gjendjen dhe nevojat e familjes përfituese.
7. Vendimi për pranimin ose jo të kërkesës merret brenda 7 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndaj këtyre vendimeve kërkuarit gëzojnë të drejtën e ankimit pranë gjykatës administrative.
8. Kontrata e shkëmbimit të dy banesave, bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit Civil për këtë kontratë. Kontrata e shkëmbimit e lidhur midis familjes që përfiton nga shkëmbimi me njësinë e vetëqeverisjes vendore, bëhet me akt noterial.

9. Kontrata e shkëmbimit ka si objekt:

- a) kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të familjes përfituese mbi banesën e re që përfitohet nga shkëmbimi me sipërfaqjen e banimit brenda normave të nevojshme;
- b) kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore mbi banesën sociale ekzistuese që është nën normën e strehimit dhe kalimin e saj si pjesë e fondit publik të banesave dhe/ose vënien e saj në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët;
- c) vlerësimin e vlerës aktuale në treg të banesës që do shkëmbehet. Kur vlera e tregut është më e lartë se kosto e investimit, njësia e vetëqeverisjes vendore aplikon koston e ndërtimit për vlerësimin e banesës që do shkëmbehet. Kosto e investimit përfshin koston e ndërtimit, vlerën e truallit dhe shpenzime të tjera. Kur vlera e investimit është më e ulët se vlera e tregut njësia e vetëqeverisjes vendore konsideron vlerësimin e banesës sipas vlerës së tregut. pagimin e diferencës së vlerës së banesës së re që përfitohet nga shkëmbimi;
- ç) përcaktimin e mënyrës së shlyerjes së saj me këste ose në mënyrë të menjëhershme;
- d) përcaktimin e rezervës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastin kur shlyerja bëhet me këste, deri në shlyerjen e plotë të diferencës së vlerës së banesës që përfitohet nga shkëmbimi;
- e) përcaktimin se me shlyerjen e plotë të vlerës së banesës së re të përfituar nga shkëmbimi, pronësia i kalon familjes përfituese.

10. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa për depozitimin e kontratës pranë zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dhe ndjek procedurat e kalimit të pronësisë sipas kontratës së shkëmbimit. Pagesat për regjistrimin e këtyre kontratave mbulohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

11. Njësia e vetëqeverisjes vendore pajis me një kopje të vërtetimit të regjistrimit të tagrit të pronësisë së banesës së re familjen.

12. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN PËR PROCEDURËN E SHKËMBIMIT TË BANESËS ME KOSTO TË ULËT

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi "Për procedurën e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët" propozohet në zbatim të nenit 48, pika 3 të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me qëllim parashikimin e procedurave për shkëmbimin e banesave sociale me kosto të ulët të përfituara nga familjet e interesuar për një banesë sociale të re për shkak se ajo ekzistuese është nën normat e strehimit, si rrjedhojë e ndryshimit të përbërjes familjare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

Projektvendimi është i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me VKM Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", me pikën me titull "Për shkëmbimin e banesave sociale me kosto të ulët të përfituara nga familjet e interesuar për një banesë sociale të re për shkak se ajo ekzistuese është nën normat e strehimit, si rrjedhojë e ndryshimit të përbërjes familjare". Projektakti është planifikuar të miratohet në katërmujorin e tretë dhe çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti janë përcaktimi i procedurës për shkëmbimin e banesave me kosto të ulët si rezultat i zgjerimit sipas normave të strehimit që i përshtaten familjes.

Gjithashtu, projektakti plotëson kuadrin ligjor të kërkuar nga Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 miratuar me Vendimin nr. 405, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave. Kjo Strategji nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale si dhe diktoi nevojën e një kuadri ligjor të ri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi " Për procedurën e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 48, pika 3 të tij. Efektet e pritshme të këtij projektvendimi janë të lidhura me politikën sociale të shtetit shqiptar, dhe synon parashikimin e procedurave për shkëmbimin e banesave sociale me kosto të ulët të përfituara nga familjet që kërkojnë një banesë sociale të re për shkak se ajo ekzistuese është nën normat e strehimit nga ndryshimi i përbërjes familjare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës.* Akti është propozuar nga një organ kushtetues (Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) përpara një organi kushtetues (Këshilli i Ministrave), i cili ka kompetencën të miratojë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Akti i propozuar ka si pasojë juridike përcaktimin e procedurave të administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme të nevojshme për grupe të shoqërisë që gjenden në një situatë të një nevoje të papritur për strehim dhe të qartësojë kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre me qëllim administrimit dhe mirëmbajtjen e strehëve të përkohëshme.

Bazuar në nenin 48, pika 3 të ligjit nr. 22/2018, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore për arsye se: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Këshilli i Ministrave), (ii) ligji, i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar, autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të cilave nxirret akti i propozuar.

- b) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit.* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 48, pika 3 e ligjit nr. 22/2018 parashikon se: "Normat e strehimit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, edhe procedura e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave." Në pikën 1, germa b) të nenit 48 parashikohet se: 1. Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 45, shkronja "a", e këtij ligji, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore: ... b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit." Bazuar në

këtë parashikim të ligjit, Ministri i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë që është përgjegjëse për strehimin propozon aktin përpara organit që ligji ka autorizuar, Këshilli i Ministrave. Projektvendimi reflekton pjesën që ka të bëjë me “procedurat e shkëmbimit të banesave sociale me kosto të ulët” për arsye se “kushtet, normat dhe standardet që duhet të plotësojnë” ato, sipas pjesës së parë të fjalisë së pikës 3, të nenit 48 të ligjit nr. 22/2018 është duke u trajtuar së bashku me nenet e tjera të këtij ligji, që ngarkojnë Këshillin e Ministrave me miratimin e “kushteve, normave dhe standardeve” që duhet të plotësojnë banesat sipas programeve që parashikon ligji nr. 22/2018.

- c) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar.* Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të BE-së.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi propozohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e procedurave të shkëmbimit të banesave sociale me kosto të ulët të përfituara nga familjet e interesuar për një banesë sociale të re për shkak se ajo ekzistuese është nën normat e strehimit, si rrjedhojë e ndryshimit të përbërjes familjare.

Projektvendimi është i strukturuar në 12 pika. Për shkak të ndryshimit të përbërjes familjare familjet që kanë përfitur banesë sociale sipas një programi tjetër kanë të drejtë ta shkëmbejnë atë me një banesë të re që i përgjigjet normës dhe standartit të përbërjes së re familjare. Pikërisht pika 1 e vendimit parashikon të drejtën që kanë familjet që kanë siguruar banesë sociale me kosto të ulët, por më vonë rezultojnë nën normat e strehimit për shkak të ndryshimit të përbërjes familjare, për ta kërkuar shkëmbimin e saj me një banesë tjetër në përputhje me normat e strehimit.

Nga pika 2 deri në pikën 4 të aktit të aktit parashikohet mënyra e vlerësimit të banesave që shkëmbehen. Për banesat që sigurohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ndërtimeve të reja parashikohet që vlera e banesës që dorëzohet nga individ/familja, të bëhet nga subjekti që zbaton programin me koston e ndërtimit, duke zbritur vlerën e amortizimit. Në këtë vlerë përfshihen të gjitha kostot që janë investuar për sigurimin e banesës, të tilla si: kostot e ndërtimit të objektit, projektit, mbikqyrjes, kolaudimit, kostot për lidhjen e objektit me energji, ujë, kanalizime e telefoni, kostot për regjistrimin në ASHK, kostot operacionale, shpenzime për marrjen e lejeve, dhe vlera e truallit, e cila përcaktohet sipas vlerave të tregut të miratuara me vendim të këshillit të ministrave për qëllim kompensimi. Në pikën 3, sqarohet mënyra e shlyerjes së diferencave që rrjedhin nga shkëmbimi i banesave, si dhe afati i shlyerjes së saj. Në pikën 4 jepet

mënyra e vlerësimit kur banesa me kosto të ulët është siguruar nëpërmjet blerjes në tregun e lirë, ku llogariten: Vlera e banesës që dorëzohet nga qytetari vlerësohet nga vlerësues të licencuar, sipas vlerës me të cilën është blerë banesa në treg, kostove për regjistrimin në ASHK, për lidhjen e kontratës dhe çdo shpenzim tjetër i faturuar dhe shpenzimeve operacionale, të cilat, kur programi zbatohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, të cilat nuk mund të jenë më shumë se 0,5% e çmimit të blerjes së banesës.

Në vijim të aktit nga pika 5 deri në pikën 7 jepen hapat e procedurës që ndiqet në rastin e shkëmbimit të banesave sociale. Procedura e shkëmbimit të banesave sociale për familjet e interesuara fillon kur subjekti që zbaton programin ka siguruar banesa me kosto të ulët nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu i lire për t'ua shitur individëve/familjeve që kanë aplikuar për këtë program sipas VKM nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore". Në pikat 6 dhe 7 jepet modalitete që lidhen me veprimet e strukturës përgjegjëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore e cila verifikon gjendjen e familjes, të sipërfaqes së banimit në banesën ekzistuese të përfituar nga privatizimet ose nga blerja në treg, si dhe të mundësive për ofrimin e një banese me kosto të ulët në përputhje me normat e strehimit të zbatueshme për gjendjen dhe nevojat e familjes përfitueseve. Vendimi për pranimin ose jo të kërkesës merret brenda 7 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndaj këtyre vendimeve kërkuesit gëzojnë të drejtën e ankimit pranë gjykatës administrative.

Nga pika 8 deri në pikën 11 parashikohet procedura për lidhjen e kontratës pas vendimmarrjes për pranimin e shkëmbimit. Në rastet kur kërkesa pranohet, në vijim të vendimit të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, struktura përgjegjëse harton një kontratë shkëmbimi midis dy banesave, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil për këtë kontratë. Kontrata e shkëmbimit lidhet me akt noterial midis familjes që përfiton banesën e re nga shkëmbimi me sipërfaqje në normat e strehimit me njësinë e vetëqeverisjes vendore. Në vendim jepen specifikime teknike që lidhen me hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së shkëmbimit, si dhe regjistrimin e saj në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kontrata e shkëmbimit që ka si objekt kalimin e ndërsjelltë të së drejtës së pronësisë midis palëve kontraktore, në favor të familjes përfituese mbi banesën e re që përfitohet nga shkëmbimi me sipërfaqjen e banimit brenda normave të nevojshme dhe kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore mbi banesën sociale ekzistuese që është nën normën e strehimit, si dhe kalimin e banesës ekzistuese që shkëmbehet si pjesë e fondit publik të banesave dhe/ose vënien e saj në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët. Në kontratë parashikohet vlerësimi i vlerës aktuale në treg të banesës që do shkëmbehet. Kur vlera e tregut është më e lartë se kosto e investimit, atëherë njësia e vetëqeverisjes vendore aplikon koston e ndërtimit për vlerësimin e banesës që do shkëmbehet. Kosto e investimit përfshin koston e ndërtimit, vlerën e truallit dhe shpenzime të tjera. Kur vlera e investimit është më e ulët se vlera e tregut njësia e vetëqeverisjes vendore konsideron vlerësimin e banesës sipas vlerës së tregut. Kontrata e shkëmbimit parashikon edhe pagimin e diferencës së vlerës së banesës së re që

përfitohet nga shkëmbimi, përcaktimin e mënyrës së shlyerjes së diferencës së vlerës së banesës saj me këste apo në mënyrë të menjëhershme, përcaktimin e rezervës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastin kur shlyerja bëhet me këste, deri në shlyerjen e plotë të diferencës së vlerës së banesës që përfitohet nga shkëmbimi. Në kontratën e shkëmbimit parashikohet shprehimisht përcaktimi se me shlyerjen e plotë të vlerës së banesës së re të përfituar nga shkëmbimi, njësia e vetëqeverisjes vendore lëshon vërtetimin e shlyerjes së plotë dhe pas kësaj, pronësia i kalon familjes përfituese.

Njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa për depozitimin e kontratës së shitjes pranë zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dhe ndjek procedurat e kalimit të pronësisë sipas kontratës së shkëmbimit. Kur shlyerja e diferencës së shkëmbimit të banesave është kryer nga përfituesi i shkëmbimit menjëherë me lidhjen e kontratës, atëherë pronësia i kalon përfituesit menjëherë. Kur kontrata hartohet si kontratë shitje me rezervë pronësie për shkak se shlyerja e diferencës së shkëmbimit është parashikuar me këste, kontrata regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si kontratë me rezervë pronësie dhe pronësia kalon tek përfituesi vetëm pasi dorëzohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës vërtetimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore për shlyerjen e plotë të diferencës së shkëmbimit. Pagesat për regjistrimin e këtyre kontratave mbulohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektvendimi, sipas pikës 12 të projektvendimit, ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Shtetërore të Kadastrës.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projekt vendim u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin dhe UNDP-së e Këshillit të Europës, me asistencën e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ekspertët kombëtarë u kontraktuan nga UNDP-ja, mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga nëpunësit e MFE-së dhe me konsulencën e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët në takime të vazhdueshme dhe periodike diskutuan lidhur me metodologjinë e punës dhe të bashkëpunimit për të vlerësuar situatën aktuale, ligjore dhe faktike të përcaktimit të institucioneve përgjegjëse për administrimin e strehëve të përkohshme dhe bashkëpunimin mes tyre. Draftet e përgatitur nga ekspertë u rishikuan disa here

në takime të përbashkëta të grupit të punës për të pasqyruar në to çdo problematikë të ndeshur në praktikën e deritanishme.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, një pjesë e të cilave do të përballohen nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësisive të vetëqeverisjes vendore. Specifikisht për këtë akt nuk mbarten kosto financiare shtesë.

PROPOZUESI

MINISTËR

Anila Denaj